




REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
Dep. DPK
Nr. 1154 _____
Protokolli _____
Nr. pages _____

Nr. Prot. _____
Br. Prot. _____
Prot. No. 03-02/4025/m
Data _____
Datum 07-12-2017
PRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 05.12.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2443/17, për zyrtarin e lartë z. Saudin Maliqi, Drejtor i Klinikës Torakale-Qendra Klinike Universitare e Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit dhe mos pajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik .

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokoli AKK-03-02-2443/17, qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Saudin Maliqi, Drejtor i Klinikës Torakale-Qendra Klinike Universitare e Kosovës.

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit, është vërejtur se zyrtari i lartë z. Saudin Maliqi, figuron si person i autorizuar në biznesin privatë me emër Ambulanca Specialistike "Kirurgjia Plus" e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr. 04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.



Pas kësaj shkrese z.Maliqi, ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, dhe është interesuar për një takim me zyrtarët e AKK-së për tu njoftuar për situatën që është duke u trajtuar.

Ne takimin e organizuar në zyrat e AKK-së me zyrtarin z.Saudin Maliqi, zyrtarët e AKK-së, e kanë njoftuar zyrtarin e lartë lidhur me rastin e iniciuar.

z.Maliqi, është pajtuar me gjendjen, por është arsyetuar se biznesi në fjalë nuk zhvillon aktivitet por ka mbet vetëm i regjistruar nga viti 2005, ndërsa ka theksuar se mundë të sjell edhe dëshmi nga Ministria e Shëndetësisë që Ambulanca Specialistike "Kirurgjia Plus" nuk funksionon dhe nuk është e licencuar, por ka deklaruar se do të veproj sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit duke sjell dëshmi .

Pas këtyre veprimeve nga z.Saudin Maliqi, kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se zyrtari i lartë z.Saudin Maliqi, nuk figuron me si person i autorizuar në biznesin e tij privat me emër, Ambulanca Specialistike "Kirurgjia Plus" edhe pse ky biznes nuk ka qenë i licencuar dhe nuk ka zhvilluar aktivitet.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga z.Saudin Maliqi, Drejtor i Klinikës Torakale-Qendra Klinike Universitare e Kosovës, duke bërë ndryshimet në biznes, duke hequr dorë nga përgjegjësit dhe të drejtat e funksionit si personi i autorizuar në biznesin e tij privat janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

